



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

V E N D I M

Nr.11, datë 17.04.2019

Për

“Miratimin për këshillim publik të dokumentit: “Analizë e tregut me shumicë të aksesit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Znj. Edlira	Dvorani	Anëtare
3 Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtare
4. Znj. Xhoana	Lilaj	Anëtare

dhe sekretare Znj. Hasime Ferati, në mbledhjen e datës 17.04.2019 sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin për këshillim publik të dokumentit: "Analizë e tregut me shumicë të aksesit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare”.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 31 e në vijim i Kreut VI (Rregullimi i Konkurrencës) të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Rregullore Nr.9 “Për Analizën e Tregut”, miratuar me VKD nr.747, date 17.07.2009, e ndryshuar;
3. Udhëzues për Procedurat e Keshillimit me Publikun miratuar me VKD nr.1183, datë 10.03.2010.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor,

- Dokumenti: “Analizë e tregut me shumicë të aksesit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare”;
- Relacioni shoqërues i projekt aktit miratues (Relacioni);
- Projekti miratues i dokumentit (projektvendimi).

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen, dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) në zbatim të ligjit Nr.9918, datë. 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në RSH”, i ndryshuar, ka si objektivi nxitjen e konkurrencës efikente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike, facilitetet shoqëruese dhe shërbimet e tjera.
2. Bazuar në praktikat më të mira të vendeve anëtarë të BE dhe BEREC dhe në funksion të objektivit të ligjit “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” për përcaktimin e tregjeve që justifikojnë rregullimin, analizës dhe përcaktimin i sipërmarrësve që kanë fuqi të ndjeshme në treg, AKEP pas këshillimit publik të dokumentit do të marrë masat rregullatorë në funksion të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.
3. Analiza e tregut me shumicë të aksesit dhe origjinimit (duke përfshirë për efekt analize dhe lidhje vertikale të tregjeve përkatëse edhe tregun me pakicë i shërbimeve celulare) rishikohet sipas praktikave më të mira në funksion të përcaktimi të tregut përkatës, analizën e testit kumulativ të tre kritereve sipas parashikimeve të Rregullores nr. 9, datë 17.7.2009 “Për analizën e tregut”, të ndryshuar, përcaktimit të një/disa sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg dhe marrjen e masave rregullatore proporcionale në funksion të sigurimit të konkurrencës efektive në tregjet përkatëse.
4. Dokumenti “Analizë e tregut me shumicë të aksesit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare” është përgatitur në zbatim të nenit 34 të ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, si edhe në pikën 6 të dispozitivit të Vendimit nr.89, datë 15.11.2018 , dhe në Strategjinë dhe Planin e Veprimit të AKEP për vitin 2019 miratuar me VKD nr. 100, datë 24.12.2018. Ky dokument:
 - a. përbën një dokument të rëndësishëm rregullator në bazë së të cilit merren vendimet për FNT në tregjet e analizuar dhe masat rregulluese respektive, të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimet rregullatore dhe tregun e komunikimeve elektronike në Shqipëri;
 - b. nga pikpamja e rregullsisë, është në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligjin 9918 dhe Rregulloren për Analizën e tregut;
 - c. nga pikpamja e ligjshmërisë është në konformitet me përcaktimet ligjore të parashikuara për analizen e tregut në nenin 31 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918,

- dhe Rregullores, përfshirë përkufizimin e detajuar të tregjeve përkatës, kriteret e përcaktimit FNT, dhe detyrimet e parashikuara për FNT;
- d. ka marrë në konsideratë rekomandimet dhe direktivat e Komisionit Evropian dhe praktikat më të mira rregullatore në vendet e Bashkimit Evropian, parimet e ligjit të konkurrencës dhe kushtet aktuale të tregut Shqiptar celular;
- e. vendosja, ndryshimi, mbajtja dhe heqja e detyrimeve për FNT është në përputhje, me përcaktimet e nenit 36 e në vijim të Kreut VI të Ligjit 9918, me pikën 5 të nenit 3 të Rregullores dhe me objektivat rregullatore të AKEP, të përcaktuara në nenin 7 të ligjit 9918;
5. AKEP ka analizuar plotësimin kumulativ të testit të 3 kriterëve për analizën e tregut përkatës sipas përcaktimeve të Rregullores së Analizës së tregut (neni 3, pika 4) dhe rekomandimit të Komisionit Evropian për tregjet përkatës të justifikueshëm për ndërhyrje ex-ante (Rekomandimi i Komisionit i datës 9 Tetor 2014).
- Prezenca e barrierave të larta dhe jo-kalimtare të hyrjes;
 - Një strukturë tregu e cila nuk ka tendencë për të shkuar në drejtimin e një konkurrencë efektive brenda afatit kohor përkatës; dhe
 - Pamjaftueshmëria e ligjit të konkurrencës për të adresuar në mënyrë të përshtatshme dështimin e tregut të marre në shqyrtim.
6. Masat rregullatore propocionale ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg do të ndërmerren vetëm në tregun e rrjedhjes së sipërme (shumicës) të aksesit dhe origjinimit në funksion të nxitjes së konkurrencës së rrjeteve celulare e kryesisht hyrjes së operatorëve virtualë të telefonisë celulare (MVNO) të cilët kanë shprehur interes për marrjen e autorizimit pranë AKEP por që kërkojnë ndërhyrjen me masa rregullatore për sipërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg sipas parashikimeve të ligjit dhe më konkretisht:
- Detyrimin e mosdiskriminimit, sipas nenit 39 të ligjit nr. 9918/2008;
 - Detyrimin e transparencës, sipas nenit 40 të ligjit nr. 9918/2008;
 - Detyrimin për akses dhe interkoneksion dhe përdorimin e përbashkët të faciliteteve të rrjetit, sipas nenit 42 të ligjit nr. 9918/2008;
 - Detyrimi për ndarjen e llogarive(neni41).
7. AKEP pas përfundimit të këshillit publik dhe marrjes së vendimeve për masat rregullatore ndaj sipërmarrësit të shpallur me fuqi të ndjeshme në tregjet përkatëse do të konsultojë në një fazë të dytë dokumentin për rregullimin e tarifave sipas parashikimeve të nenit 45, 56 e në vijim të ligjit nr. 9918/2008;

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të dokumentit të cituar më lart, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar, Këshilli Drejtues i AKEP

V E N D O S I:

- Të miratojë nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit “*Analizë e tregut me shumicë të aksesit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare*”, sipas dokumentit bashkëlidhur;

2. Proçedura e këshillimit publik të kryhet për një periudhë 60 ditore nga data e publikimit të dokumentit.
3. Ky Vendim dhe Dokumenti “*Analizë e tregut me shumicë të aksesit dhe origjinimit të thirrjeve në rrjetet celulare*”, të publikohen në faqen e internetit akep.al.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

KRYETAR

Ilir Zela

ANËTAR

Edlira Dvorani

ANËTAR

Ketrin Topçiu

ANËTAR

Xhoana Lilaj